



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201401453/5

Tiranë ___/___/2014

Lënda: *Rekomandim për emërimin në detyrë të punonjësit të Policisë së Burgjeve A.H.*

Drejtuar : Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve
Z. Artur ZOTO

Tiranë

I nderuar Zoti Zoto,

Me shkresat Nr. K2/A49-2 Prot., datë 05.09.2014 dhe Nr. K2/A49-4 Prot., datë 05.11.2014 ju kemi vënë në dijeni se, në Institucionin e Avokatit të Popullit ka bërë ankesë shtetasi A.H.. Ankuesi shkruan se ka qënë punonjës policie i rolit të mesëm, me gradën "Komisar" në IEVP Drenovë, Korçë. Me Urdhrin Nr. 5847, datë 29.05.2014 të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve është transferuar në IEVP Bënçë, Tepelenë.

Në bazë të urdhrin të transferimit, në datën 05.06.2014 ai është paraqitur në IEVP Bënçë dhe ka marrë takim me drejtorin dhe zëvendës drejtorin e këtij institucioni. Ata i kanë thënë se, nuk mund ta sistemonin në punë sepse nuk kishin vend të lirë.

Pas kësaj situatë ai është paraqitur disa herë në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve për të sqaruar problemin e tij. Në këtë institucion ka marrë takim me shefin e personelit, por problemi nuk i është zgjidhur. Gjithashtu ankuesi shkruan, se u është drejtuar me letër rekomandë Drejtorit të IEVP Bënçë në datën 13.06.2014 dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve në datat 18 dhe 27 qershor 2014, por përsëri nuk ka gjetur zgjidhje dhe nuk ka marrë përgjigjen letrave të tij.

Ndërkohë ai pretendon se, marrëdhëniet financiare i janë ndërprerë në datën 07.06.2014.

Për të bërë të mundur shqyrtimin e kësaj ankese, me shkresat e cituara më sipër ju kërkua verifikimin e saj dhe kthimin e përgjigjes lidhur me pretendimet e ngritura nga ankuesi.

Ndonëse afati ligjor i kthimit të përgjigjeve kërkesave tona kaloi, ju nuk na i dërguat ato. Mosdërgimi i përgjigjeve nga ana juaj ndaj kërkesave tona përbën një qëndrim jo korrekt në përmbushjen e detyrave institucionale.

Ndërkohë ky qëndrim ka sjellë mungesën e korrektesës tonë ndaj qytetarit për shqyrtimin e këtij rastit dhe kthimin e përgjigjes lidhur me të.

Nga shqyrtimi i kësaj ankese konstatojmë se, qëndrimi i mbajtur ndaj ankuesit A.H. nga ana juaj dhe e vartësve tuaj nuk është korrekt, dinjitoz dhe ligjor. Nëse në IEVP Bëncë nuk do të kishte vende të lira pune për gradën që ai mban, atëhere nuk duhet të ishte nxjerrë nga ana juaj Urdhri Nr. 5847, datë 29.05.2014 për transferimin e tij në këtë institucion. Nëse në këtë IEVP ka vende të lira, si është e mundur që vartësit tuaj nuk e zbatojnë urdhrin e nxjerrë prej jush.

Gjithashtu ne konstatojmë se, për shkak të qëndrimit të mbajtur ndaj ankuesit, duke e transferuar dhe mos emëruar në fakt, si dhe duke i ndërprerë marrëdhëniet financiare, atij i janë shkelur të drejtat morale dhe ekonomike të garantuara nga ligji Nr. 10 032, datë 11.12.2008, "Për Policinë e Burgjeve", i ndryshuar. Ndërkohë theksojmë se, në asnjë dispozitë të këtij ligji nuk parashikohet ndërprerja e marrëdhënieve financiare për shkak të mos pasjes së vendeve të lira ndërkohë që punonjësi i policisë "de jure" vazhdon të jetë i emëruar në detyrë.

Për të rivendosur në vend të drejtat e cënuara ankuesit, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: *"Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike"* dhe në nenin 21/b të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999 *"Për Avokatin e Popullit"*, i ndryshuar, ku parashikohet se: *"Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive"*,

REKOMANDOJMË:

Marrjen e masave të menjëhershme për emërimin në detyrë në përputhje me gradën të punonjësit të Policisë së Burgjeve "Komisar" A.H..

Pagimin e ankuesit që nga data e ndërprerjes padrejtësisht të marrëdhënieve financiare deri në emërimin "de fakto" të tij në detyrë.

Për qëndrimin dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditorë, sipas nenit 22 të Ligjit Nr. 8454 dt.04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit".

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

K O M I S I O N E R I

Arben SHKËMBI